



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PROKURORI I PËRGJITHSHËM**

**URDHËR Nr. 257 Datë 14. 12. 2005**

**PËR  
KOMUNIKIMIN ME PUBLIKUN DHE MEDIAN, SI DHE PËR RUAJTJEN E  
SEKRETIT TË VEPRIMEVE HETIMORE**

***Me synim,***

- për të realizuar komunikim të drejtë dhe objektiv me opinionin publik dhe media;
- për të ruajtur sekretin e veprimeve hetimore në procesin penal dhe shmangur praktikat e gabuara në publikimin e të dhënave dhe akteve hetimore, si dhe;
- për të krijuar një praktike të unifikuar, në përputhje me dispozitat ligjore, në policinë gjyqësore dhe në Prokuroritë e të gjitha;

***Ne mbështetje,*** të neneve 24 pika 4, 103, 279 e vijues të K. Pr. Penale, të neneve 8 pika 2, 6, 40 e vijues të ligjit Nr. 8737 datë 12. 02. 2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë " dhe të neneve 14 e 15 të ligjit Nr. 8677 datë 2. 11. 2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore",

**URDHËR:**

1. Drejtuesit e Prokurorive të shkallës së parë dhe të apeleve, ne mënyrë periodike, të komunikojnë me opinionin publik dhe organet e medias, për veprimtarinë e prokurorisë (treguesit e ndjekjes penale, ngritjes së akuzës në gjykatë dhe të ekzekutimit të vendimeve penale), për probleme të përgjithshme ose të veçanta të kriminalitetit në juridiksionin e tyre, duke shmangur publikimin e çdo të dhëne që dëmton procesin e hetimeve, që cenon dinjitetin dhe jetën private të personave apo që cenon të drejtat e të miturve dhe moralin publik.
2. Komunikimi me median, duke ruajtur sekretin e hetimeve dhe sa u përmend në pikën 1 më sipër, të bëhet veçanërisht:
  - a) për fakte sensitive që pretendohen në kallëzimet penale apo ngjarjet kriminale;
  - b) për pozitën procedurale të personave për të cilët ka interes publiku dhe media;
  - c) për çështjet e rëndësishme që përfundon hetimi dhe dërgohen për gjykim.

3. Komunikimi me median për çështjet e përmendura në pikën 1 më sipër të bëhet çdo 3-muaj. Komunikimi me median për çështjet e përmendura në pikën 2 më sipër, në Prokuroritë e rretheve gjyqësore të kategorisë së parë, të bëhen çdo dy javë, ndërsa në Prokurorinë e rrethit gjyqësor Tiranë dhe në Prokurorinë për Krime të Rënda Tiranë të bëhet çdo javë.
4. Prokurorët, oficerët dhe agjentët e policisë gjyqësore të të gjithë niveleve, të respektojnë detyrimin ligjor, që parashikon neni 279 e vijues i K. Pr. Penale dhe ky urdhër, për të ruajtur sekretin e veprimeve hetimore, provave, akteve dhe të dhënave të mbledhura në fazën e hetimeve paraprake, deri në momentin që aktet i nënshtrohen shqyrtimit gjyqësor.
5. Për ngjarje nga vepra penale të rënda dhe sensitive për publikun, drejtuesit e Prokurorive njoftojnë menjëherë drejtorët përkatës të Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm, të cilët njoftojnë menjëherë Prokurorin e Përgjithshëm.
6. Komunikimi me median dhe publikun, për treguesit e veprimtarisë së prokurorisë në shkallë vendi dhe i të dhënave për çështje sensitive për publikun, duke ruajtur sekretin e hetimeve dhe sa u përmend në pikën 1 më sipër, bëhet nga zëdhënësi i Prokurorit të Përgjithshëm, pasi të jetë dhënë pëlqimi i Prokurorit të Përgjithshëm.
7. Shkeljet e neneve 103, 279 e vijues të K. Pr. Penale, të neneve 6 e 40 e vijues të ligjit "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë..." dhe të nenit 14/1(a, ç) të ligjit "Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore", kur nuk përbëjnë vepër penale, konsiderohen shkelje të disiplinës në ushtrimin e detyrës ndaj prokurorit, oficerit ose agjentit të policisë gjyqësore.
8. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen prokurorët, oficerët dhe agjentët e policisë gjyqësore të të gjitha niveleve. Për të ndjekur dhe kontrolluar zbatimin e tij ngarkohen drejtuesit e prokurorive të shkallës së parë, të apeleve dhe të Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm.
9. Urdhri nr. 112 datë 19. 08. 2002 shfuqizohet.
10. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**PROKURORI I PERGJITHSHEM**